



DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 12 mars 2026

VLERËSIM

Lënda: Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregulator (RIA) për projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 99/2024 ‘Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë’”.

Vlerësimi i përgjithshëm: 83/100

Përgjithësisht pozitiv

A) Informacione të përgjithshme mbi procesin

Emërtimi i propozimit të politikës

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 99/2024 ‘Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë’”

Ministria udhëheqëse	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
Numri/data e RIAs	2026 – MEI – Nr.6
Statusi	Finale
Data e marrjes për shqyrtim	11 mars 2026
Data e komenteve të fundit	12 mars 2026
Numri i komenteve të kryera/të reflektuara	13/11
Numri i ripunimeve	2

A) Konteksti i politikës

Qëllimi i kësaj nisme është të ndryshojë varësinë e Inspektoriatit të Përgjithshëm, nga Kryeministria që është aktualisht, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

B) Vlerësimi i përgjithshëm

Drejtoria vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

Për arsyet e lartpërmendura, Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë. Njëkohësisht, është kryer një analizë mjaftueshmërisht cilësore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë përgjithësisht të detajuar

C) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë **plotësisht** në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të thellohet më tej analiza ekonomike sasiore ekonomike (kosto/përfitimi), për të gjitha grupet e prekura.
2. Të zhvillohen më tej masat e zbatimit dhe monitorimit të opsionit të preferuar.
3. Te redaktohet nga ana gramatikore raporti për të përmirësuar qartësinë e tij.